



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 132, Datë 29.08.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E MIRATIMIN E DRAFTIT TË RREGULLORES SË LIDHJEVE TË REJA NË RRJETIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Neni 42 pika 3 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 16 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.08.2019, mbasi shqyrtoi Relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore me nr.79/12 prot, datë 28.08.2019, për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e draftit të Rregullores së lidhjeve të reja në rrjetin e gazit natyror,

Konstatoi se:

- Neni 16, pika 18 i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, ERE vendos standardet dhe kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit, veçanërisht për kohën që u duhet operatorëve të transmetimit e të shpërndarjes për të bërë lidhjet dhe riparimet, si dhe mbikëqyr zbatueshmërinë e tyre;
- Neni 32, i ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, ERE miraton metodologjinë dhe përcakton tarifën për aksesin në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, tarifën për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së dhe tarifën e furnizimit për klientët fundorë që furnizohen në bazë të detyrimit të shërbimit publik;
- Neni 42 pika 3 i ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon gjithashtu se, OST-ja publikon kushtet dhe detyrat e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat dhe tarifën për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit. Këto kushte dhe detyrime zbatohen në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë klientët;
- Neni 53, i ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi, me kusht që sistemi i shpërndarjes të ketë kapacitet të mjaftueshëm dhe të plotësojë të gjitha kushtet e tjera teknike e tregtare;
- Neni 54 i ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses në sistemin e shpërndarjes, brenda kufijve

të kapaciteteve të shpërndarjes dhe rregullave teknike, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, të miratuar nga ERE

- Ky dokument, hartuar mbështetur në sa më sipër, do të përcaktojë procedurën e aplikimit, kriteret për miratimin dhe realizimin e një lidhjeje të re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese dhe përcaktimin e tarifave përkatëse për lidhjen e paisjeve të përdoruesit të sistemit me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes së gazit natyror
- Draft-Rregullorja për lidhjet e reja në rrjetin e gazit natyror është hartuar duke marrë parasysh:
 - Fazat e hershme të zhvillimit të sektorit të gazit në vend, dhe nevojën thelbësore për zhvillimin e infrastrukturës së gazit, e lidhur kjo me domosdoshmërinë për koordinim midis Planeve të zhvillimit të rrjetit dhe lidhjeve të reja,
 - Nxitjen e investimeve në zhvillimin e infrastrukturës së gazit,
 - Përvojat e disa vendeve, përfshirë vendet e BE-së, Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë por edhe jashtë rajonit,
 - Përvojën ekzistuese të grumbulluar në sektorin shqiptar të energjisë elektrike.

Kjo rregullore synon të sigurojë:

- zbatimin e së drejtës së secilit aplikant për t'u lidhur në rrjetin e gazit,
- tarifa lidhjeje transparente dhe të drejta,
- zbatimin e sigurt të shërbimeve të lidhjes dhe kosto lidhjeje të drejta,
- një dokument të thjeshtë dhe praktik, që përshtatet me nivelin aktual të zhvillimit,
- një numër kërkesash minimale të cilësisë dhe afateve kohore në zbatimin e lidhjeve të reja.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e draftit të “*Rregullores së lidhjeve të reja në rrjetin e gazit natyror*”.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR

Petrit AHMETI